

EPPC Kosovo kërkon një **Key Account Manager** për klientin e saj, një ndër kompanitë më prestigjioze e cila ofron produkte dhe shërbime në fushën e IT-së, në rajon.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Përgjegjës kryesor i shitjes dhe zhvillimit të aktiviteteve të biznesit në Kosovë;
- Përgatit dhe zbaton planin strategjik për të arritur objektivat e shitjeve dhe për të rritur numrin e klientëve;
- Vlerëson dhe raporton mbi zhvillimet dhe ndryshimet e tregut;
- Krijon marrëdhënie afatgjata me klientë dhe partnerë të rinj, njëkohësisht duke i ruajtur me ata ekzistues;
- Harton dhe zbaton procesin e shitjes dhe strategjisë së marketingut për pjesën e tregut që mbulon;
- Punon për arritjen e targeteve të përcaktuara të shitjes;
- Raporton në mënyrë të vazhdueshme tek drejtori i kompanisë.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare (*e preferueshme në IT, Ekonomi apo Menaxhment*);
- **Përvojë e dëshmuar në menaxhim shitjesh Business to Business/B2B** (*e preferueshme në tregun e IT-së*);
- Aftësi të shkëlqyera për të prezantuar specifikat e dallueshme të produkteve dhe shërbimeve;
- Aftësi shumë të mira organizative dhe të ofroj zgjidhje të shpejtë dhe me cilësi për klientët;
- **Aftësi shumë të mira në komunikim verbal dhe të shkruar në gjuhën Shqipe dhe Angleze;**
- Aftësi shumë të mira në përdorimin e veglave si MS Project, MS Visio, MS Excel;
- Të jetë person energjik, i motivuar, miqësor dhe i/e aftë të punojë me saktësi dhe nën presion.

Të dhënat:

Pozicioni:	Key Account Manager;
Vendndodhja:	Prishtinë;
Kontrata:	Sipas Ligjit të Punës;
Paga:	Shumë konkurruese;
Aplikimet mbyllen:	31.05.2019.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke përmendur pozicionin **'Key Account Manager'** në adresën e e-mail-it:

kosovo@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.